



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2024:133383

Datë: 28.01.2025

Numri i dokumentit: 06767097

C.nr.437/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. H nga fshati K, Komuna e Istogut, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Valon Demiraj – avokat në Istog, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, në çështjen juridike kompensim i pagës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jashtë seance gjyqësore me datë 28.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes -

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. H, ashtu që: DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të pagesës shtesë - përqindjes së inflacionit për periudhën nga data 01.09.2021 e deri më datën 20.11.2022, t'ia paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 594.73 Euro, me kamatë ligjore 8% në vit, nga data 07.05.2024 [data e paraqitjes së padisë], e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurale në shumë të përgjithshme prej 125 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses A. H, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë shumën prej 264.72 Euro, në emër të kompensimit të diferencën mbi bazën e inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar në këtë gjykatë padi me datë 07.05.2024, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensim mbi bazën e inflacionit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 13.11.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 18.11.2024 [fakt i cili vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal], duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: “Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”.

Gjykata themelësinë e kësaj kërkesëpadie e mbështeti në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht: nga kontrata me numer të protokollit 4.../21 e datës 08.09.2021 e lidhur në mes të paditurës dhe këtu paditëses nga e cila vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse e mësimi klasor në Sh.f.m.u "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" në U me kontratë në kohë të pacaktuar që nga data 01.09.2021 si dhe nga lista e pagave për paditësen nga e cila vërtetohet paga bazë e paditëses në vlerë prej 421.20 Euro (koeficienti 5.6).

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, asaj të vitit 2017 (e aplikueshme nga data 18.04.2017-21.01.2021) dhe asaj të vitit 2021 (e aplikueshme nga data 22.01.2021-21.11.2022), ku në nenin 35 par.10 të të njëjtave përcaktohet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Gjykata bazuar në të lartëcekurat vendosi ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, që t'ia kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar normës së inflacionit: për vitin 2021 – 3.4 % (4 muaj), si dhe për vitin 2022- 11.6% (11 muaj). Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtrësja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata vlerësoj se kompensimi i diferencës në pagë mbi bazën e inflacionit paditëses i takon sipas pagës bazë 421.20 Euro [fakt i provuar nga lista e pagave] e jo sipas pagës neto të cilën e realizon paditësja, prandaj, gjykata pas përlllogaritjeve duke marr për referencë pagën bazë të paditëses, erdhi në përfundim se shumta e përgjithshme e kërkuar nga paditësja në padi e tejkalon shumën e përgjithshme të aprovuar nga kjo gjykatë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës ashtu që lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet 104 euro për përpilim të padisë dhe 21 euro për taksë gjyqësore.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 paragrafi 10, të Kontratave Kolektive të lartëcekura, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.